





REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

01/Nr. Prot. 2-155/5055  
Nje. Org. 3  
Nr. i fax 3  
Data 11.06.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	11.06.2024
PËR/ZA TO:	z. Shpejtim Gacaferri - Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës 
NGA/OD/FROM:	z. Jemmir Jasiqi - Drejtor për Ekonomi dhe Zhvillim
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite në KPF dhe në Kuvendin informataen mbi zhvillimin e turizmit në Komunën e Junikut



Të nderuar,

Duke marrë parasysh pozitën gjeografike të Komunës së Junikut, resurset natyrore dhe kulturore, turizmi nuk është i zhvilluar në nivelin e duhur. Megjithatë, ne po punojmë intensivisht për të përmirësuar këtë situatë dhe për të shfrytëzuar potencialin e madh që ofron zona jonë.

Aktualisht, Komuna e Junikut është në përfundim të qendrës për informim turistik, e cila do të shërbejë si një urë lidhëse ndërmjet turistëve dhe atraksioneve turistike. Kjo qendër do të ofrojë informacione të detajuara për vendet që duhen vizituar, aktivitetet që mund të zhvillohen dhe shërbimet që ofrohen. Gjithashtu, në kuadër të kësaj qendre, Komuna e Junikut është në përgatitje të guidave dhe materialeve promovuese që do të ndihmojnë në orientimin dhe informimin e vizitorëve.

Pothuajse në përfundim është edhe shenjëzimi i shtegut Via Dinarica, një itinerar ndërkombëtar malor i cili do të ketë pikënisjen nga Qendra për Informim Turistik në Junik. Ky shteg do të ofrojë mundësi të jashtëzakonshme për ecje dhe eksplorim të natyrës, duke e bërë Junikun një destinacion të preferuar për adhuruesit e aventurës dhe natyrës. Gjithashtu, anëtarë nga shoqatat e ndryshme të Junikut, kanë vijuar trajnimet për kërkim dhe shpëtim malor, dhe pjesëmarrësit janë certifikuar në këtë drejtim, gjithashtu janë anëtarë të rregullt të Shërbimit për Kërkim dhe Shpëtim Malor të Kosovës, duke garantuar sigurinë e vizitorëve tanë.

Komuna e Junikut së fundmi është përfituese e një projekti i financuar nga BE-ja, i cili fokusohet në investimin në infrastrukturë. Ky projekt përfshin hapjen e shtigjeve të reja që do të lehtësojnë qasjen e turistëve në Bjeshkët tona, ndërtimin e dy pikave vrojtuese përgjatë rrugës kryesore që të çon në bjeshkët e Junikut, si dhe organizimin e dy festivaleve që do të mbahen në komunën tonë. Këto investime do të përmirësojnë ndjeshëm përvojën e vizitorëve dhe do të rrisin atraktivitetin e zonës sonë.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, Komuna e Junikut është në pritje të fillimit të trajnimit për guida kulturore. Ky bashkëpunim synon të krijojë një staf të kualifikuar që do të promovojë në mënyrë profesionale historinë, traditat dhe kulturën e Junikut.

Rruga kryesore që të dërgon në bjeshkët e Junikut është pothuajse drejt përfundimit të asfaltimit, gjë që do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e numrit të turistëve dhe vizitorëve. Kjo rrugë pritet të lehtësojë qasjen dhe të ofrojë një përvojë më të mirë për vizitorët, duke e bërë Junikun një destinacion tërheqës gjatë gjithë vitit.

Komuna e Junikut, në bashkëpunim me SwissContact, është në proces të realizimit të master planit për zhvillimin e turizmit në bjeshkët e Junikut. Ky plan ambicioz synon të përmirësojë infrastrukturën turistike, të promovojë atraksionet natyrore dhe kulturore të zonës, dhe të krijojë mundësi të reja për zhvillimin ekonomik lokal. Implementimi i këtij plani pritet të sjellë një rritje të numrit të vizitorëve dhe të kontribuojë në ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Junikut.

Gjithashtu, është planifikuar organizimi i eventeve tradicionale si Ditët e Gjeravicës, Dita e Gëslitenjës dhe Dita e Plisit, të cilat synojnë promovimin e vlerave tradicionale dhe kulturore të Komunës së Junikut. Këto ngjarje do të jenë mundësi të shkëlqyera për turistët që të përjetojnë nga afër traditat dhe mikpritjen tonë.

Sa i përket turizmit dimëror, në bjeshkët tona operon kompania kroate Lynx Freeride, e cila ka kontribut të jashtëzakonshëm në promovimin e bjeshkëve të tona, duke e renditur bjeshkën e Junikut si një ndër vendet më të mira në botë për disiplinen freeride.

Ndonëse ka shumë punë për të bërë, ne jemi të bindur se këto projekte dhe aktivitete do të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në Komunën e Junikut, duke sjellë përfitime për komunitetin tonë dhe duke e vendosur Junikun në hartën e destinacioneve turistike të Kosovës dhe më gjerë.

Me respekt!